

## NË EMER TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm,** Gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në çështjen penale ndaj te pandehurit: SH.J. nga fsh...., komuna e ..., për shkak të veprës penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.I.nr.278/2015, dt.07.12.2016, te cilën aktakuzë e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit Slavica Mavric, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e të pandehurit SH.J. dhe Prokurorit të Shtetit Slavica Mavric, në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 366 të KPP-së, me datë 25.02.2019 është shpallur publikisht, ndërsa me datë 27.02.2019 ka përpiluar këtë:

### A K T G J Y K I M

SH.J., me nofkën “...” i biri i ... dhe ..., e gjinisë ..., i lindur me ... në fshatin ..., komuna e ..., ku edhe jeton, veteran, i martuar, baba i dhjetë fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse,

Me datën 07.03.2012 rreth orës 19:30 min. në fsh. ..., komuna e ..., ka përdorur armë duke shtënë në ajër, ashtu që në oborrin e tij ka shtënë disa herë në ajër me armën AK/47 dhe pastaj me automjetin e tij ‘Golf 2’ ngjyrë ari, ka vazhduar në drejtim të panjohur, ku në vendin e ngjarjes janë gjetur dy gëzhoja të kalibrit 7.62 mm.

Me këtë ka kryer veprën penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykatat në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 62, 69, 73, të KPRK-së, dhe nenit 365, 450 dhe 451 të KPP-së, e:

### G J Y K O N

1.Me dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.

2.Obligohen i akuzuari që t’i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, dhe atë në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata, në bazë të nenit 47 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të akzuarit, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muajve ia zëvendëson me dënim me gjobë, ashtuqë:

3.Obligohet i akuzuari që t’a paguajë gjobën në shumën prej 450 € (katërqind e pesëdhjetë euro), të cilën gjobë janë të obliguar ta paguajnë në afat tre (3) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë në 3 (tre) këste të barabarta, më së largu deri me datën 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t’ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

## Ar sy e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar në Gjykatë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, Aktakuzën PP.I.nr.278/2015, dt.07.12.2016, ndaj te pandehurit: SH.J., nga fsh...., komuna e ..., për shkak të veprës penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimi fillestar të dt.22.02.2019 pas leximi të aktakuzës e ka precizuar dispozitivin e aktakuzës – përshkrimin e gjendjes faktike, ashtu që ne vend të fjalës “në oborrin e shtëpisë së ...” vendoset fjala “në oborrin e tij”.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 22.02.2019, ashtu që në këtë seancë, i pandehurit ka deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen, dhe duke theksuar se e ndjejn veten fajtor për veprën penale që iu vihet në barrë dhe duke shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur dhe në të njëjtën kohë kanë premtuar se nuk do të kryej sjellje të tilla në të ardhmen.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, ngase kjo është në pajtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës, e po ashtu pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas njoftimit paraprakisht nga gjykata për favorët dhe disfavorët e pranimit të fajësisë. Andaj i propozon gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit t'i merr parasysh të gjitha rrethanat.

Gjyqtari, pas dëgjimit të palëve, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin, andaj edhe ka marr aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke ia tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit dhe pas sqarimeve të mjaftueshme; se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata, po ashtu ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Kallëzimi penal 2012-BC-338 datë 20.12.2012; Raporti mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes i datës 07.03.2012; Lista e dëshmitëve e datës 07.03.2012; Formulari për ekspertim i datës 07.03.2012; Raporti i ekspertizës i datës 05.11.2013; dhe, dokumentacioni përkatës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Në kontekst të pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe në vlerësimin dhe analizimin e provave materiale që janë pjese përbërëse e kësaj çështje penale, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, se në veprimet e të pandehurit kemi të bëjmë me elemente të veprës penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK-së. Prandaj, Gjykata, e shpall fajtor të pandehurin, për shkak të veprës penale të lartcekur, ngase veprimet e tij, i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën edhe janë përgjegjës penalisht.

Në rastin konkret në raport me çështjen penale ndaj të pandehurit nuk ekzistojnë rrethana të cilat kishin me përjashtuar përgjegjësin penale të tij në këtë çështje penale.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të pandehurit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPK-ës. Si rrethana lehtësuese mori pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, shprehjen e keqardhjes, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryejnë veprime të paligjshme, është mbajtës i familjes, kohen e kryerjes së vepres penale viti 2012,

Ndërsa, si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti.

Andaj, Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se, shqiptimi i dënimit me burgim ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve. Poashtu, Gjykata shpreh bindjen se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë sipas nenit 41 të KPRK-ës, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen dhe te beje rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave te tjerë ne kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, dhe nga te gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është ne përputhshmëri me shkallen e përgjegjësisë dhe te rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për te pandehurit.

Gjykata me pëlqimin e të akuzuarit dhe në pajtim me nenin 47 të KPRK-së, dënimin me burg prej 6 muajve ia zëvendësoi në dënim me gjobë, duke i shqiptuar gjobën në shumën prej 450 euro, duke e vlerësuar se edhe me këtë zëvendësim do të arrihet qëllimi i dënimit sipas KPRK-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika dhe 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 463 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.823/2016, dt.27.02.2019**

Procesmbajtësja:  
Selvije Kostërci

Gjyqtari

---

**Rrahman BEQIRI**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.